

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7065
E premte, 8 dhjetor 2023
Çmimi 0.50

Interpoli lëshon urdhërarrest për Radoičiqin | **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LAJČAKU: PA NORMALIZIM TË RAPORTEVE, KOSOVA DHE SERBIA NUK MUND TA ËNDËRROJNË TË ARDHMEN EVROPIANE




I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajčák, ka thënë të enjten në Bruksel se pa normalizim të raporteve, Kosova dhe Serbia nuk mund ta ëndërrojnë të ardhmen evropiane. Gjatë debatit për zgjerimin të zhvilluar nga organizata "Miqte e Evropës", Lajčaku ka theksuar se në disa tema ky dialog ka shënuar përparim. Ai bëri thirrje që të mos humbet koha për implementimin e obligimeve nga dialogu dhe të mos humbet rasti për avancim në rrugëtimin drejt BE-së

OPINION

A MËSOI NDOKUSH GJË NGA GAZA? **F.7**

Muhamet MAVRAJ

AKTUALE



SENATORËT REPUBLIKANË NË SHBA BLOKOJNË NDIHMAT PËR UKRAINËN DHE IZRAELIN **F.2**

KRYEPARLAMENTARI KONJUFCA NË SHBA, VIZITËN E NIS TEK AMBASADORI DUGOLLI **F.3**

DËNOHEN ME NGA DY VJET BURGIM TË AKUZUARIT PËR SULM NDAJ GAZETARIT SYLA **F.7**

EKONOMI



FONDI PËR GARANCI KREDITORE DHE SIDA SUEDEZE BËJNË MARRËVESHJE PREJ 14.9 MILIONË EUROSH **F.8**

PRODHIMET BUJQËSORE JANË RRITUR PËR 29 PËR QIND **F.8**


SPORT

HIDHET SHORTI PËR "ELITE ROUND" PËR KUALIFIKIMET E EURO 2024, KOSOVA NË GRUPIN E PARË **F.10**

NË VITIN 2022 NDODHËN 2 088 SHKURORËZIME **F.7**



QEVERIA NDAN FONDE PËR PUNËSIMIN E GRAVE TË MBIJETUARA NGA DHUNA **F.8**



RENOVA PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

A mësoi ndokush gjë nga Gaza?



Muhamet MAVRAJ

Në fillim ishte trushpërlarja, fjalimet e mëdha, sulmet ndaj kundërshtarëve të brendshëm

politikë, premtimet qiellore, pastaj furia e tërbimi mbi hebrejtë. Matematika për analfabetët funksionalë. Fiks dy muaj që nga e shtuna e përgjakshme e Hamasit, më 7 tetor. Mizoritë dhe kundërmizoritë hakmarrëse edhe gurit ia shpojnë zemrën. Gaza, sikurse thamë atëherë, do të zhduket dhe po zhduket. Izraeli është më i madh sesa Kosova, por më i vogël sesa Shqipëria, ndërsa territoret palestineze janë sa gjysma e

Kosovës, por në tkurrje tutje. Bota (Lidhja) Arabe përbëhet nga 22 shtete arabe, plot mbretër e sheikë, me 500 milionë arabë. Këta, - dhe Turqia e Irani mendjemadh, si gjithmonë, kur vjen dita e provës e lënë Palestinën e gjorë në zjarr. Janë struktur në mënyrë epike. Ata e dinë mirë çfarë i gjen nëse nuk rrinë kështu mirë paluar. Lufta e sotme është ekstremisht mizore sepse shkon përtej kuptimit palestinez (kundër boshtit Rusi-Iran), ndaj

rrafsh me tokë do të bëhet gjithçka përballë. Rrjedhimisht, trushpërlarët e Hamasit nuk punuan kurrë as për Gazën, as për Palestinën, por për zhdukjen e saj të maskuar me fjalime patriotike, për rusët e për Iranin dhe të tillët, dhe, për ironi e jo për habi, efektivisht, edhe për interesat e Izraelit, sepse: 7 tetori i kobshëm i Hamasit ishte leje me vulë botërore në dorën e Izraelit për zhdukjen e Gazës. Kjo luftë do të ishte dhe doli

të jetë provimi më i rëndë moral i ndërgjegjes ndërkombëtare, botës perëndimore e lindore, veriore e jugore, arabe e joarabe. Ka rënë bota në kurthën e vet moti. Në Gazë nuk ka kushte për dinjitet human as për të vdekurit, as për të gjallët. Dhe kështu do të jetë edhe në dy muajt e ardhshëm, së paku. Dhe i tërë shekulli aty e gjetiu. Trushpërlarja është taksirat i madh. Rreshtimi i gabuar zhduk atdheun.

Senatorët republikanë në ShBA bllokojnë ndihmat për Ukrainën dhe Izraelin

WASHINGTON, 7 DHJETOR - Shpenzimet emergjente përmes së cilave do të ofroheshin miliarda dollarë si ndihmë e re sigurie për Ukrainën u bllokuan në Senatin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të mërkurën derisa republikanët kërkuan masa më të ashpra për ta kontrolluar migrimin në kufirin me Meksikën. Ishin 49 senatorë që votuan për, ndërsa 51 të tjerë kundër, duke e lënë kështu masën prej 110.5 miliardë dollarësh me më pak se 60 votat e nevojshme në Senatin prej 100 anëtarësh. Votimi u bë sipas linjave partiake, me çdo republikan të Senatit që votoi kundër, së bashku me senatorin Bernie

Sanders, një i pavarur që përgjithësisht voton me demokratët, por kishte shprehur shqetësime për financimin e "strategjisë aktuale çnjerëzore ushtarake" të Izraelit kundër palestinezëve. Projektligji do të sigurote rreth 50 miliardë dollarë ndihmë të re sigurie për Ukrainën si dhe para për ndihmë humanitare dhe ekonomike për qeverinë në Kiev, plus 14 miliardë dollarë për Izraelin derisa lufton me Hamasin, grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian në Gaza. Udhëheqësi i shumicës në Senat, demokrati Chuck Schumer, gjithashtu votoi kundër, në mënyrë që të mund



ta prezantojë përsëri masën në të ardhmen.

Pas votimit, Schumer foli për rreziqet nëse Ukraina bie.

Republikanët thanë se ishte thelbësore t'i mbështesnin politikat e forta të migracionit dhe kontrollin e kufirit jugor. Edhe nëse projektligji kalon në Senat, ai duhet të miratohet në Dhomën e Përfaqësuesve të kontrolluar nga republikanët, ku dhjetëra republikanë kanë votuar kundër ndihmës për Ukrainën, duke përfshirë kryetarin Mike Johnson. Republikanët dhe demokratët kanë debatuar me muaj se si ta adresojnë kërkesën e Bidenit për miliarda dollarë fonde për Ukrainën derisa ajo lufton pushtuesit rusë, për Izraelin pas sulmeve të 7 tetorit nga militantët islamikë të Hamasit dhe për ndihmë humanitare ndërkombëtare.

Jep dorëheqje ministri britanik për Imigrim për shkak të politikës së re për azil

LONDËR, 7 DHJETOR - Ministri britanik për Imigrim, Robert Jenrick, ka dhënë dorëheqje, duke thënë se drafti i një legjislacioni qeveritar që parasheh jetësimin e një skeme për dëbim të migrantëve në Ruandë nuk ka shkuar mjaftueshëm larg. Jenrick ka thënë në letrën e dorëheqjes se legjislacioni ka qenë një prej mundësive të fundit për ta luftuar krizën me anije të vogla para zgjedhjeve të vitit të ardhshëm.



Legjislacioni është dashur të shkojë përtej, për t'i kufizuar mundësitë që gjykata vendore dhe ndërkombëtare ta sfidojnë politikën, ka thënë ai. "Qeveria ka përgjegjësi t'i vendosë interesat kombëtare përtej interpretimeve të kontestueshme të ligjit ndërkombëtar. Unë nuk mund të punoj me legjislacionin e propozuar, sepse nuk besoj se ofron mundësitë më të mira për sukses", ka thënë ai në letrën

e dorëheqjes të cilën e ka postuar në platformën "X". Jenrick ka qenë aleat i ngushtë politik i kryeministrit britanik Rishi Sunak. Si anëtar i parlamentit prej vitit 2014, Jenrick ndër vite ka shërbyer në pozita të ndryshme nëpër ministri. Ditët e fundit Jenrick, i cili është ministër për Imigrim prej tetorit të vitit të kaluar, ka qenë shumë i ashpër në nevojën për ta luftuar shkuarjen e migrantëve në Angli me anije të vogla.

Zgjedhjet presidenciale ruse mbahen më 17 mars

Moskë, 7 dhjetor - Dhoma e lartë e parlamentit të Rusisë, Këshilli i Federatës, ka caktuar 17 marsin për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale. Këshilli e

miratoi vendimin gjatë një seance më 7 dhjetor. Vladimir Putin, i cili ka qenë në pushtet si kryeministër ose president që nga viti 1999, ende nuk e ka shpallur

synimin e tij për të marrë pjesë në zgjedhje për një mandat tjetër gjashtëvjeçar, megjithëse pritet shumë që të marrë pjesë. Një ndryshim kushtetues i

lejoi Putinit mundësinë për të kandiduar në zgjedhje. Deri më tani për të kandiduar kundër Putinit nuk është paraqitur asnjë sfidues serioz.



Haradinaj takon ambasadorin e Danimarkës në Kosovë, diskutojnë për forcimin e marrëdhënieve

Prishtinë, 7 dhjetor - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, është takuar me ambasadorin e Danimarkës në Kosovë, Christian Gronbech-Jensen. Gjatë takimit Haradinaj ka thënë se është diskutuar për zhvillimet politike në vend dhe për forcimin e marrëdhënieve bilaterale mes dy vendeve. "Danimarka

gjithmonë ka luajtur rol konstruktiv duke i dhënë mbështetje të fuqishme vendit tonë në proceset euroatlantike dhe të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Kënaqësi të presim në takim ambasadorin e Danimarkës në Kosovë, Christian Gronbech-Jensen dhe delegacionin nga Ministria e Drejtësisë së këtij

shteti. Gjatë këtij takimi biseduam për zhvillimet politike në vend dhe forcimin e marrëdhënieve bilaterale mes Republikës së Kosovës dhe Danimarkës. I konfirmova mbështetjen time dhe të Aleancës në ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet dy vendeve tona për transferimin e të burgosurve", ka thënë Haradinaj pas takimit.



Komisioni për Administratë Publike ia përcjell Kuvendit dy projektligje

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, kryesuar nga Valon Ramadani, kryetar, ka mbajtur të enjten mbledhjen e radhës për të shqyrtuar dy projektligje të propozuara.

Për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedurë të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, të pranishëm ishin përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Zëvendësministri i kësaj ministrie, Bardhyl Dobra, ka paraqitur dhe ka shtjelluar



rëndësinë e projektligjit duke treguar fazat e harmonizimit të

tij me 38 ligje të tjera dhe duke potencuar se ky projektligj, si i

tillë, do të sjellë reformë të re në administratën publike.

Me të hedhur në votim, me shumicë votash, projektligji u votua në parim dhe do të propozohet për seancë plenare. Më tutje u shqyrtua Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare të cilin e paraqiti dhe arsyetoi drejtori i Departamentit për OJQ-të, Bedri Zyberaj, së bashku me përfaqësues të tjerë nga MPB-ja. Anëtarët e komisionit, pas diskutimeve dhe rekomandimeve të tyre lidhur me projektligjin në fjalë dhe nenet përkatëse të tij, miratuan edhe këtë projektligj, i cili do të procedohet për shqyrtim të mëtutjeshëm nga komisionet e përhershme të Kuvendit.

Kuvendi i Shqipërisë miraton buxhetin për vitin 2024, mbyllet seanca mes tymueseve dhe shpërthimeve



TIRANË, 7 DHJETOR - Buxheti për vitin 2024 i Shqipërisë është miratuar në një seancë të pazakontë plenare me 74 vota për, 4 kundër dhe asnjë abstenim.

Deputetët e opozitës grumbulluan karriget rreth foltore, mes përplasjes me Gardën, ndezën sërish tymuese me ngjyra, ndërsa u dëgjuan edhe shpërthime në sallë.

Mes përplasjes së tavolinave dhe thirrjeve "Turp, turp", kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, ka miratuar nen për nen "Buxhetin 2024". "Fatkeqësisht opozita vazhdon në rrugën e paligjshmërisë, por fati i një njeriu nuk mund të jetë fati i shqiptarëve. Shqiptarët duan votimin e buxhetit për investime, për rritjen e pagave, për shërbime më cilësore. Nuk

mund ta merrni peng Kuvendin", ka thënë Nikolla.

Deputeti demokrat Asllan Dogjani u përjashtua nga seanca pas ndezjes së tymueses. Garda e Republikës ishte vendosur në gatishmëri për ta siguruar mbajtjen e rregullit të kësaj seance.

Opozita pati paralajmëruar kaos dhe bllokim të punës në Kuvend pas përjashtimit me 10 ditë të 6 deputetëve: Sali Berisha, Flamur Noka, Edi Paloka, Albana Vokshi dhe Elda Hoti, si protagonistët e tensioneve herën e shkuar për të sabotuar me flakadanë e flakë punën e Kuvendit.

Kujtojmë se ky është i njëjti skenar i përsëritur në seancat e fundit plenare në Kuvend, ndërsa në seancën e së hënës u tentua t'u vihej flaka karrigeve të grumbulluara në foltore.

Kryeparlamentari Konjufca në ShBA, vizitën e nis nga ambasadori Dugolli

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, po qëndron për vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai është parë ta ketë vizituar fillimisht Ambasadën e Kosovës në Uashington, me ç'rast ka

takuar ambasadorin Ilir Dugolli. "Nder i veçantë vizita e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca në Ambasadën e Republikës së Kosovës në ShBA, në nisje të vizitës në Uashington, D.C. Kryeparlamentari Konjufca dhe delegacioni i

përbërë nga deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi, shefi i stafit Ilir Kërçeli dhe këshilltari Donik Sallova, u pritën nga ambasadori Ilir Dugolli dhe stafi i Ambasadës", ka njoftuar Ambasada e Kosovës në Uashington.





Lajčaku: Pa normalizim të raporteve, Kosova dhe Serbia nuk mund ta ëndërrojnë të ardhmen evropiane

I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajčák, ka thënë të enjten në Bruksel se pa normalizim të raporteve, Kosova dhe Serbia nuk mund ta ëndërrojnë të ardhmen evropiane. Gjatë debatit për zgjerimin të zhvilluar nga organizata “Miqte e Evropës”, Lajčaku ka theksuar se në disa tema ky dialog ka shënuar përparim. Ai bëri thirrje që të mos humbet koha për implementimin e obligimeve nga dialogu dhe të mos humbet rasti për avancim në rrugëtimin drejt BE-së

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 DHJETOR - I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajčák, tha të enjten në Bruksel se ka përparim për zbatimin e disa marrëveshjeve të arritura në dialogun ndërmjet dy palëve. Ai e tha këtë gjatë debatit për zgjerimin të zhvilluar nga organizata “Miqte e Evropës”. Lajčaku ka theksuar se e ardhmja evropiane e rajonit të Ballkanit Perëndimor nuk mund as ëndërr të shihet pa normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. “Normalizimi i

raporteve mes Kosovës dhe Serbisë është një çështje me rëndësi strategjike. Pa këtë normalizim nuk mund as të ëndërrojmë të ardhmen evropiane. Kemi përparim kohën e fundit në këtë drejtim. Së shpejti do ta mbyllim dosjen e energjisë. Ka përparim në çështjen e targave, në çështjen e personave të pagjetur, në çështjen e zgjedhjeve lokale në veri dhe në zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve”, ka pohuar Lajčaku, duke shtuar se ai është në kontakt të vazhdueshëm me palët për ta vazhduar zbatimin. Ai bëri thirrje

që të mos humbet koha për implementimin e obligimeve nga dialogu dhe të mos humbet rasti për avancim në rrugëtimin drejt BE-së.

Lajčaku ka deklaruar se viti i ardhshëm do të jetë një vit me kalendar të ngjeshur politik, sepse do të ketë zgjedhje në Bashkimin Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas Lajçakut, tash është një moment i ri në procesin e zgjerimit, që është shumë më i favorshëm sesa më parë. Ky moment i ri, tha ai, është krijuar nga presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, dhe agresioni i tij ndaj Ukrainës”. Megjithatë, emisari i

BE-së tha se “gjeopolitika e ka hapur derën për integrim në BE, por ajo nuk do t’ju kalojë vetvetiu juve përmes kësaj dore, sepse për një gjë të tillë duhet të përmbushen kushtet”. “Për herë të parë e shoh BE-në më të gatshme për Ballkanin sesa Ballkani për BE-në”, u shpreh Lajčaku, duke përsëritur që vendet e rajonit duhet t’i zgjidhin të gjitha çështjet e hapura mes tyre në mënyrë që një ditë të mos mund të bllokojnë njëra-tjetrën në rrugën drejt BE-së.

Në Bruksel po zhvillohet debati kushtuar procesit të zgjerimit të organizuar nga “Miqte e Evropës”. Në këtë debat, Bashkimi Evropian porositi vendet e Ballkanit Perëndimor se nuk ka më kohë për të pritur që t’i normalizojnë raportet ndërmjet tyre porse kjo duhet të bëhet shpejt, si kusht për t’i shfrytëzuar mjetet nga plani për rritje ekonomike i miratuar më 8 nëntor nga Komisioni Evropian. Plani për rritje ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor

parasheh një paketë të madhe të asistencës financiare prej 6 miliardë eurosh për periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2027. Sipas planit, nga kjo shumë deri në 2 miliardë euro do të shkonin si asistencë pa kthim, ndërsa 4 miliardë në formën e kredive të favorshme apo investimeve kapitale. Një pjesë e këtyre mjeteve financiare do të mund të shkonin përmes pagesave direkte në buxhetet e vendeve të rajonit për t’u përdorur për këto qëllime. Në debat marrin pjesë edhe ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, drejtori i përgjithshëm për zgjerim në Komisionin Evropian, Jan Coopman, dhe shumë pjesëmarrës të tjerë. Coopman ka thënë se qëllimi i BE-së është t’i integrojë sa më shumë vendet e rajonit edhe para se të bëhen anëtare të BE-së, përfshirë edhe integrimin në tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian. Në takim morën pjesë edhe ministrat nga disa vende të

Avokati i Thaçit e përballë ish-zyrtaren e OSBE-së me faktet e "Panda"-s, ajo pranon se raporti i saj mund të kishte pasaktësi



HAGË, 7 DHJETOR - Inskeniimi i vrasjes së gjashtë të rinjve serbë në një kafene në Pejë, i njohur si rasti "Panda", është diskutuar dje edhe në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, gjatë dëshmisë së ish-zyrtares së OSBE-së, Sandra Mitchell.

Për vrasjen e të rinjve serbë atë kohë ishin akuzuar shqiptarët. Lidhur me këtë, Mitchell është marrë në pyetje nga avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Keohe.

Për rastin "Panda" në Pejë, i cili ka ndodhur më 14 dhjetor 1998, Keohe e ka pyetur dëshmitaren

nëse e dinte se operacioni me vrasjen në "Panda" ishte një operacion i rrejtshëm me motivin që ky krim t'i atribuohet UÇK-së, mirëpo përgjigja e Mitchell nuk është dëgjuar. "Ka të bëjë me vrasjen e civilëve serbë me një numër të viktimave të paidentifikuara që, në fakt, duken vrasje të pashpjegueshme. Ekziston dyshimi se forcat e UÇK-së vranë jo vetëm shqiptarë të Kosovës të moderuar, por edhe serbë. Duheshin nga të dy komunitete. Incidenti në veçanti tërhoqi vëmendjen e ndërkombëtarëve më

14 dhjetor. Kryerës të paidentifikuar kryen vrasjen e 6 serbëve të rinj të Kosovës në kafenenë 'Panda' në Pejë", ka lexuar raportin e OSBE-së Keohe, ndërsa dëshmitarja Mitchell ka thënë se i kujtohet si incident.

Duke iu referuar raportit të OSBE-së, Keohe ka thënë se aty përmenden motive të hakmarrjes nga ana e shqiptarëve të Kosovës lidhur me vrasjen e 30 anëtarëve të UÇK-së. "Këto ishin vetëm pretendime, por pretendime të mirëbazuara që kërkonin hetim të mëtejshëm", ka thënë Mitchell.

Keohe ia ka kujtuar dëshmitares

edhe deklaratën e politikanit serb Vuk Drashkoviç, i cili i kishte thënë një gazete serbe se autoritetet e Serbisë me urdhër të Sllobodan Millosheviçit e kanë orkestruar këtë operacion. "Ai i ka thënë një gazete serbe se RBB-ja e udhëhequr nga Rade Markoviçiqi e ka orkestruar këtë masakër nëpërmjet udhëheqësit paramilitar Millorad Ulemek dhe me urdhër të Sllobodan Millosheviçit, a e dini këtë?", ka thënë Keohe.

Dëshmitarja Mitchell ka mohuar të ketë njohuri për një gjë të tillë.

Po ashtu, Mitchell ka mohuar të ketë pasur njohuri që qëllimi i këtij incidenti ishte që UÇK-ja të portretizohej si organizatë terroriste para komunitetit ndërkombëtar. Ndërsa për artikullin që i është paraqitur, ajo ka thënë se nuk e ka parë më herët, raportin "Demokracia".

Avokati Keohe ka kërkuar që ky dokument të pranohet si provë materiale, por që është kundërshtuar nga prokurorja Deborah Mayer, me arsyetimin se dëshmitarja nuk kishte njohuri për këtë dokument. Ndërsa kryetari i trupit gjykues, Charles Smith III, ka kërkuar që vetëm të identifikohet si dokument për t'u vendosur më vonë. Pas kësaj, dëshmitares i është paraqitur edhe një dokument tjetër nga "Balkan Insight", i vitit 2018, lidhur me rastin "Panda" në Pejë. "Aty citohet se Valdimir Vuçiqeviq është një prokuror për krime lufte i Serbisë që: nuk ka pasur shqiptar në atë kohë dhe i gjithë operacioni u krye me synimin e atribuimit të palës tjetër, a e dini këtë fakt se vrasja në kafenenë 'Panda' ishte me një operacion të tillë, me synimin e atribuimit të fajit UÇK-së?", ka thënë Keohe.

Dëshmitarja ka thënë se nuk ka njohuri. Megjithatë, sa i takon raportit të saj lidhur me këtë ngjarje, dëshmitarja ka thënë se nëse informacionet në artikuj janë të vërtetë, atëherë konkludimi që ka nxjerrë del i pasaktë.

KDI-ja kërkon zbatim të plotë të ligjit për mbrojtje të sinjalizuesve

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Në tryezën e së enjtes u publikua raporti "(Mos)Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në nivelin ekzekutiv". Ky është raporti i dytë në serinë e raporteve që skanojnë implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në institucionet publike në vend. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kërkuar nga

institucionet në nivelin ekzekutiv, por edhe institucionet e tjera publike, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar zbatim të plotë të Ligjit për Mbrojtje të Sinjalizuesve. KDI-ja, po ashtu, i inkurajon punonjësit në sektorin publik të kontribuojnë në kulturën kundër-korrupsion duke e përdorur sinjalizimin si mjet,

por edhe si vlerë për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik. Kjo tryezë u mbajt në kuadër të kampanjës "Zero Korrupsion" me përfaqësues nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përfaqësues nga institucionet e nivelit qendror, përfaqësues të shoqërisë civile dhe medieve.



rajonit. Ata mbështetën idenë për integrimin gradual para integritimit formal në BE, por jo të shihet si alternativë e anëtarësimit. "Për ta realizuar këtë, rajoni duhet t'i tejkalojë problemet e hapura. Nuk mund të pranojmë vende të cilat kanë raporte të helmuara", ka thënë Coopman, duke përmendur çështjet e hapura rreth kufijve. Këto kushte, sipas diplomatëve në BE, kanë të bëjnë, para së gjithash, me Kosovën dhe Serbinë, të cilat janë të përfshira në procesin e dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. "Ne do ta kushtëzojmë planin e rritjes me normalizimin e raporteve. Kjo duhet të ketë

përparim në këtë [aspekt]. Nuk kemi më kohë për të prituri", ka deklaruar Coopman. Ai tha se vlera e mjeteve nga ky plan është e madhe dhe nëse shtetet nuk i shfrytëzojnë, qytetarët do të humbasin.

Ministri për çështje evropiane i Çekisë, Martin Dvorak, rikujtoi se nuk do të ketë mundësi për asnjë vend kandidat që ta shmangë përmbushjen e kriterëve në procesin e avancimit drejt BE-së.

Ndërsa ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, bëri thirrje që BE-ja të dëshmojë se kësaj radhe mundësia për integrim në BE është vërtet reale. Ai ka thënë se Serbia po bën

shumë në procesin e reformave sikur edhe në ndihmën për Ukrainën. "Serbia po bën shumë për Ukrainën, por ju lutem të mos e bëni të madhe këtë, sepse nuk do të ishte në interes të të gjithëve në Serbi", është shprehur Hill.

Plani i ri për rritje ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, i miratuar nga Komisioni Evropian më 8 nëntor të këtij viti, është i bazuar në katër shtylla.

Shtylla e parë është "forcimi i integritimit ekonomik në tregun unik të BE-së". Kjo do të varet nga përshtatja e vendeve të rajonit me rregullat e tregut unik dhe paralelisht hapja e tregut të tyre në sektorët përkatës për vendet

fqinje.

Shtylla e dytë e këtij plani është "forcimi i integritimit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor përmes tregut të përbashkët rajonal". Kjo, sipas përvojës së BE-së, do të ndikojë në një rritje potenciale ekonomike prej 10-përqindësh.

Shtylla e tretë e këtij plani është "përshtetimi i reformave fundamentale". Kjo nënkupton sundimin e ligjit që ndihmon edhe në tërheqjen e investimeve direkte të huaja dhe forcon stabilitetin rajonal.

Shtylla e katërt e planit të ri të Komisionit Evropian për rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor është "rritja e

asistencës financiare për t'i ndihmuar reformat". Këtu përfshihet edhe propozimi për 6 miliardë euro ndihmë.

Pasi vendet e rajonit në raportet tregtare me Bashkimin Evropian përfitojnë edhe nga Marrëveshjet përkatëse e Stabilizim-Asociimit, KE-ja propozon të shkohet edhe ndërtej kësaj, duke bërë edhe ndryshime në këto marrëveshje për të mundësuar kushte të barabarta në treg dhe mes vendeve në procesin e zgjerimit dhe vendeve anëtare të BE-së.

Të gjitha këto qëllime janë në përputhje edhe me idetë që po realizohen përmes Procesit të Berlinit si dhe krijimin e "tregut të përbashkët rajonal".

Inspektorati i kryeqytetit kontrollon taksitë dhe autobusët që s' respektojnë itinerarin e tyre

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Inspektorati i Kryeqytetit ka ndërmarrë një aksion të menjtë për t'i kontrolluar taksitë e paautorizuara dhe autobusët që nuk respektojnë itinerarin e tyre.

Kështu është bërë me dije nga Inspektorati përmes një njoftimi në faqen zyrtare në "Facebook". Po ashtu, njoftimit i janë bashkëngjitur edhe disa fotografi ku shihet se

aksioni është zhvilluar në disa lokacione. "Inspektorati i Kryeqytetit, përveç aktiviteteve të ndryshme ditore, sot ka vazhduar me aksionin e kontrolleve të taksive të

paautorizuar dhe autobusëve që nuk respektojnë itinerarin e tyre dhe qarkullojnë edhe në brendi të kryeqytetit", ka njoftuar Inspektorati i Kryeqytetit.



Për ta shmangur përdorimin e 2 eurove false, Trafiku Urban fton qytetarët të pajisen me bileta përmes sms-ve

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Trafiku Urban në Prishtinë u ka bërë thirrje qytetarëve të pajisen me bileta përmes sms-ve në mënyrë që të shmangët përdorimi i parave të gatshme, veçanërisht i monedhës 2 euro e cila po qarkullon me të madhe false në Kosovë. Në njoftim theksohet se duke pasur parasysh se kohët e

fundit është rritur numri i monedhave të falsifikuara, punonjësit e Trafikut Urban në terren, përkatësisht konduktorët, po ballafaqohen me sfida shtesë me pranimin dhe kthimin e parave të imta gjatë inkasimeve të biletave. Kryeshefi ekzekutiv i Trafikut Urban, Burim Maraj, u bënë thirrje qytetarëve të pajisen me

bileta përmes SMS dhe të kenë mirëkuptim. "I lusim qytetarët të kenë mirëkuptim për procedurat e verifikimit të monedhave nga punonjësit tanë gjatë kryerjes së pagesave dhe të shfrytëzojnë sa më shumë mundësinë e pajisjes me bileta përmes SMS, formë kjo e cila është më e lehtë dhe më e sigurt", ka thënë ai.



Lladrovci thotë se Drenasi ka përmbushur 12 parimet e Këshillit të Evropës për Qeverisje të Mirë

DRENAS, 7 DHJETOR - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të enjten ka pritur në takim drejtorin e Zyrës Regionale të OSBE-së në Mitrovicë, Nikolaos Kavallaris-Ladis, me të cilin ka diskutuar lidhur me çështjet e përgjithshme të zhvillimeve në komunën e Drenasit. Lladrovci i ka uruar mirëseardhje drejtorit Ladis dhe e ka falënderuar për punën e kësaj organizate shumë të rëndësishme për shtetin tonë dhe politikën që e mbulojnë qeverisjen lokale.

Ai e ka njoftuar Ladisin për instalimin e barazisë gjinore në Drenas, projektet që janë



zhvilluar, ato që janë duke u zhvilluar dhe për projektet e

rëndësishme që pritet të realizohen gjatë viteve në

vazhdim. "Jemi kampionë të qeverisjes së mirë, transparente,

llogaridhënëse, me respektim të barazisë gjinore në pushtetin lokal dhe pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje. Drenasi ka përmbushur 12 Parimet e Këshillit të Evropës për Qeverisje të Mirë Demokratike dhe për këtë jemi shpërblyer nga Shoqata Evropiane për Demokraci Lokale", ka thënë kryetari Lladrovci, duke i njoftuar të pranishmit edhe për sfidat që po i sjellin projektet e filluara, të papërfunduara me vite nga niveli qendror, projektet me kosto të lartë e të papërbalueshme për komunën, ruajtjen e ambientit, ujin e pijshëm, kolektorët, ruajtjen e pronës publike etj.

'Artpolis', marsh dhe performancë artistike në Prishtinë kundër femicidit: 'Kriminelët të dënohen'



PRISHTINË, 7 DHJETOR - Me thirrjet "Vrasësit në burg", "Boll ma", të enjten në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë u mbajt marshi "Stop Femicidit! #BollMa" dhe performanca artistike "Hope Bubble". Aty u tha se vrasja e grave dhe dhuna sistematike e patriarkatit duhet të marrin

fund. "Femicidi, mizogjenia e maskuliniteti toksik vazhdojnë të na terrorizojnë përditshëm. Jeta e grave cenohet çdo ditë, në shtëpi, në rrugë, në punë, në hapësira publike dhe private", kanë thënë nga "Artpolis" - Qendra për Art dhe Komunitet e cila e ka organizuar këtë marsh.

Më tutje u tha se femicidi është urgjencë kombëtare. "Është momenti i fundit që institucionet tona dhe shoqëria ta trajtojnë me seriozitetin më të lartë vrasjen e grave dhe dhunën ndaj tyre dhe t'i dënojnë maksimalisht kriminelët përkitazi me ligjin".

Përurohet ura mbi lumin Lushta

MITROVICË, 7 DHJETOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka përuar urën mbi lumin Lushta në lagjen Bair të Mitrovicës, e cila ishte dëmtuar gjatë vërshimeve të fundit. Drejtuesit e komunës theksuan

se ura u rregullua falë bashkëpunimit të mirë të komunës me disa biznese dhe banorë të kësaj lagjeje. "Banorët e lagjes Bair me rregullimin e urës do ta kenë më të lehtë lëvizjen, ndërsa

institucionet lokale do të vazhdojnë të jenë në shërbim të qytetarëve për ta përmirësuar jetën e përditshme të tyre", thuhet në njoftimin e komunës së Mitrovicës.



Dënohen me nga dy vjet burgim të akuzuarit për sulm ndaj gazetarit Syla

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë të enjten ka shpallur aktgjykim fajësues për tre të akuzuarit për sulm ndaj gazetarit Valon Syla, duke i dënuar me nga dy vjet burgim. Ata janë dënuar për veprën penale "lëndim i lehtë trupor".

Valon Syla ishte sulmuar në lagjen Bregu i Diellit në Prishtinë në dhjetor të vitit 2020, pak pasi kishte dalë nga një studio televizive. Ai pati shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se është sulmuar për shkak të disa postimeve kritike për disa udhëheqës fetarë.

Të dënuarve L. D., K. H. dhe O. H. do t'u llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14 prill deri me 7 dhjetor 2023. "Të akuzuarve u është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak, ndërsa obligohen që secili veç e veç t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës; në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 200 eurosh, ndërsa shumën prej njëqind 100 eurosh ta paguajnë për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin", njoftoi gjykata. Gjykata ka refuzuar kërkesën

e Sylës për dëmshpërblim prej 30 mijë eurosh.

Pas vendimit, Syla ka reaguar në "Facebook" duke thënë se "Kosova pra ka shpresë, kur secili prej nesh e kryen detyrën e vet dhe e ka përnjëmend. Pra, unë e kryejta timen, kolegët e mi gazetarë e kryen të vetën, policia reagoi dhe i kapi në afat rekord sulmuesit fanatikë, drejtësia po ashtu në fund krejt këtë mund e shpërbleu me drejtësi të merituar".

Në nëntor të këtij viti Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës pati njoftuar se në



vitin 2022 regjistroi 33 raste, ku gazetarët ishin viktime të dhunës fizike, të sulmeve apo

kërcënimeve, ndërkaq në vitin 2021 u regjistruan 29 raste të tilla.

Interpoli lëshon urdhërarrest për Radoiçiqin

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Organizata ndërkombëtare e policisë, Interpol, lëshoi urdhërarrest për ish-nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoiçiq, në lidhje me sulmin e armatosur në Banjskë - pjesa veriore e Kosovës. Lajmin e konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" Nenad Rashiç, ministër për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës. Ai tha se urdhri është lëshuar me ndërmjetësimin e misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, në bazë të kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës.

Meqë Kosova nuk është anëtare e Interpol-it, urdhërarrestet ndërkombëtare lëshohen në këtë mënyrë.

Interpol-i i tha "Radios Evropa e Lirë" se nuk komenton për rastet ose individët specifikë.

Nga kjo agjenci sqaruan se, me kërkesë të vendeve anëtare dhe pas verifikimit të pajtueshmërisë, ata lëshojnë të ashtuquajtura "njoftime të kuqe".

"Njoftimi i kuq" i alarmon policinë në gjithë botën për të arratisurit që kërkohen ndërkombëtarisht dhe ndihmon në sjelljen e tyre para drejtësisë. Megjithatë, është në kompetencën e vendeve



anëtare të Interpol-it për të vendosur nëse do të arrestojnë një person ose jo.

Radoiçiq mori përgjegjësinë për sulmin e 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit, ku grupe të armatosura serbësh sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Në përlëshjet e armatosura që

pasuan, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Përmes një letre publike të lexuar nga avokati i tij më 29 shtator, Radoiçiq itha se "personalisht" e ka organizuar rebelimin e armatosur në veri të Kosovës.

Ai e mohoi përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore të

Serbisë në këtë sulm.

Radoiçiqi, ish-nënkryetar i Listës Serbe në Kosovë, u mor në pyetje nga Prokuroria e Serbisë në muajin tetor dhe u ngarkua me disa vepra, përfshirë trafikim armësh dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm. Megjithatë, gjykata në Beograd e liroi nga

paraburgimi, por ia konfiskoi dokumentet.

Autoritetet e Kosovës bënë përgjegjëse udhëheqjen shtetërore të Serbisë për sulmin që nxiti shqetësime për qëndrueshmërinë në rajon, ndërsa Serbia e mohoi përfshirjen dhe drejtoi gishtin kah serbët e Kosovës.

Në vitin 2022 ndodhën 2 088 shkurorëzime

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e shkurorëzimeve për vitin 2022. Sipas këtyre statistikave, në vitin 2022 janë regjistruar 2 088 shkurorëzime. Numri më i madh i shkurorëzimeve, sipas komunave, ishte në: Prizren (209 raste), ose 10 %; Gjakovë (172 raste), ose 8,2 %; Ferizaj (145 raste), ose 6,9%. Sipas kohëzgjatjes së martesës, dominon viti 5-9 me 31,5 %, viti 10-14 me 14,5 % dhe viti i katërt (4) me 9,1 % e të shkurorëzuarve..

Shkurorëzimet e regjistruara brenda Kosovës janë më pak në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

Te shkurorëzimet sipas grupmoshave, te femrat dominonte moshja 25-29-vjeçare me 452 shkurorëzime, ose 21,6 %, kurse te meshkujt dominonte moshja 30-34 vjeç me 431, ose 20,6 %. "Këto janë të dhëna administrative. Burimi i të tyre është Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës (ARC). Sipas dispozitave ligjore mbi udhëheqjen e regjistrave themeltarë për

kurorëzime, rastet regjistrohen në mënyrë të obligueshme në regjistrat e lartë-cekur, në vendin në të cilin ka ndodhur ngjarja, pa marrë parasysh se personat me të cilët lidhet ngjarja, vendbanimin e përhershëm e kanë në atë vend ose në ndonjë vend tjetër", theksohet në njoftimin për medie.

ASK-ja ka bërë me dije se do të vazhdojë me grumbullimin e të dhënave përmes pyetësorëve të veçantë statistikorë, për shkurorëzime



SHK-1, gjatë këtij viti kalendarik, sikurse deri më tani. "Grumbullimi i të dhënave vazhdon të bëhet çdo muaj dhe do të shërbejë

për krijimin e bazës së të dhënave, si dhe krahasimin me të dhënat administrative", bëhet me dije në njoftimin për medie.

Qeveria ndan fonde për punësimin e grave të mbijetuara nga dhuna

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka lansuar të enjten masën e punësimit për gratë e mbijetuara nga dhuna, përmes së cilës synohet punësimi i tyre. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se ekzekutivi do të subvencionojë 70 për qind të pagës për të punësuarat dhe kjo do të vlejë për gjashtë muaj. Sipas qeverisë, identiteti i grave që aplikojnë do të ruhet me konfidencialitet të plotë. “Kur gratë janë në gjendje të sigurojnë jetën financiarisht, ato kanë më shumë mundësi të largohen nga marrëdhënia e dhunshme dhe të fillojnë një jetë të re normale”, ka deklaruar Kurti. Me këtë rast, Kurti ka thënë se kjo po i shtohet skemës “Qeveria për familjet”, përmes së cilës deri tani kanë përfituar familjet që nuk e kishin askënd të punësuar. “Vitin e kaluar, në kuadër të skemës ‘Qeveria për familjet’, u siguroam që secila familje në Kosovë të ketë një bazë të të ardhurave me qëllim rritjen e mirëqenies shoqërore. Përfituan 2 mijë e 377 familje, të

cilat nuk e kishin askënd të punësuar. Kësaj skeme po i shtojmë një veçori të re që ka cak punësimin e të mbijetuarave nga dhuna në familje e kjo bëhet krahas përmirësimit të qasjes në shërbime sociale dhe rritjes së mbështetjes për strehimoret e të mbijetuarave nga dhuna në familje. Nga sot të gjitha gratë që ishin viktime të dhunës në familje do të mund të jenë përfituese të kësaj skeme”, është shprehur Kurti.

Kurti ka shpjeguar se gratë duhet të drejtohen në zyrat e punësimit në komunat e tyre përkatëse dhe, pas regjistrimit, këshilltarët e punësimit do të sigurohen që ato të ndërmjetësohen në biznese të regjistruara të cilat ofrojnë pozita të lira të punës.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se subvencionimi do të jetë 300 euro në muaj. “Kemi të bëjmë me një masë që subvencionon 70 për qind të pagës për biznesin që punëson një grua që është viktimë e dhunës në familje, deri në masën 300 euro në muaj subvencioni, paga mund të shkojë



edhe më lart. Kjo vlen për 6 muajt e parë”, ka thënë Murati.

Kërkesa për këtë masë ishte bërë nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në kuadër të fushatës “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, që ka nisur më 25 nëntor. Haxhiu

tha se shumica e grave që janë të mbijetuara të dhunës në familje janë të pasigurta. “Sfida më e madhe e tyre është mungesa e një vendi të punës, sikurse strehimi. Për shkak të kushteve të rënda financiare detyrohen të kthehen në vendin ku ka ndodhur dhuna”,

ka thënë Haxhiu. Ajo tha se me Ligjin për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, “pasuritë që konfiskohen do t’u jepen kategorive që kanë më së shumti nevojë dhe të mbijetuarave nga dhuna në familje”.

Fondi për Garanci Kreditore dhe SIDA suedeze me marrëveshje prej 14.9 milionë eurosh

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) kanë nënshkruar marrëveshjen e garancisë në vlerë prej 14.9 milionë eurosh. Aty u tha se kjo marrëveshje është në të mirën e ekonomisë së Kosovës. Sipas tyre, kjo ngjarje vërteton përkushtimin e institucioneve për ta nxitur rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë në vend, të plotësuar me mbështetjen e vazhdueshme të SIDA-s.

Kryesuesi i Bordit të FKGK-së, Agan Azemi, ka thënë se bashkëpunimi me SIDA-n ka filluar qysh në vitin 2018 me marrëveshje fillestare me vlerë 10 milionë euro. Ai ka bërë me dije se marrëveshja e arritur prej 14.9 milionë eurosh parasheh ta



lehtësojë qasjen në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

“Marrëveshja e garancisë e finalizuar sot në vlerë 14.9 milionë

euro shërben si dëshmi e mëtejshme e angazhimit tonë për

të garantuar kredi për NMVM-të”, ka thënë Azemi, duke shtuar se kjo marrëveshje parashikohet ta lehtësojë qasjen në financa për NMVM-të duke u mundësuar një kredidhënie deri në 55 milionë euro.

Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, ka thënë se FKGK-ja mbetet mekanizëm shumë i rëndësishëm për të mirëmbajtur dhe avancuar edhe më tej objektivin për sistem financiar stabil.

Ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, ka theksuar se synojnë të krijojnë 2 700 vende të punës me marrëveshjen prej 55 milionë eurosh.

Të rëndësishme këtë marrëveshje e konsideroi edhe ministrja e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë, Rozeta Hajdari.

Prodhimet bujqësore janë rritur për 29 për qind

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Shoqata “Mjedra e Kosovës” ka mbajtur konferencën e tetë “Formimi i së ardhmes në sektorin e mjedrës”, në të cilën është paraqitur potenciali i kultivimit të mjedrës në Kosovë, sfidat aktuale të zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori si dhe risitë në sektorin e mjedrës në nivel global. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Faton Peci, ka

thënë se ka rritje të produkteve bujqësore 29 për qind, dhe se subvencionet janë rritur në 25 për qind. Ndër të tjera, ai tha se dyert e ministrisë janë gjithmonë të hapura për prodhuesit. “Kosova ka një klimë të shkëlqyeshme që mundëson kultivimin e mjedrës, përkundër sfidave që po paraqiten në intervale kohore dhe, po ashtu, edhe në rënie të çmimit të mjedrës. Edhe pse e kemi vërejtur një rënie në

vlerën e eksportit, në anën tjetër kemi një rritje të produkteve bujqësore 29 për qind si pasojë e rritjes së çmimit në nivel global. Të dhënat që i kemi siguruar nga Dogana flasin për një eksport në vlerë prej 4.43 milionë eurosh”, ka thënë ministri Peci. Edmond Gashi, menaxher i projektit “Promovimi i Ndërmarrësisë” në GIZ, ka pohuar se do ta mbështetin sektorin e bujqësisë edhe vitet në vazhdim.



RECENSION LIDHUR ME BOTIMIN E DYTË TË LIBRIT TË MR. SCI. HAMËZ LLADROVCIT

“Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2022)”



Prof. dr. Haxhi FERATI

Ndjehem shumë i privilegjuar dhe i respektuar, që po më jepet rasti për të shkruar parathënien, për librin e një studiuesi të ri të një fushe aq të veçantë – fushës gjeopolitike e gjeostrategjike, e cila po rilind në petkun e saj të ri. Çdo libër i ri nga fusha gjeopolitike e gjeostrategjike, është një ngjarje e llojit të vet me interes për shkencën dhe për dijen në përgjithësi, e sidomos për studiuesin e ri shqiptar, i cili e sfidon vetën në përballje me një fushë të re studimi, me aq peshë të madhe për shtetin dhe kombin në këtë kohë të turbulencave të mëdha gjeopolitike e gjeostrategjike rreth gjeohapësirës shqiptare dhe gjithandej në Ballkan, në Evropë dhe në botë. Jam thellësisht i bindur se, libri nuk do të zhgënjë lexuesin, përkundrazi, duke pasur parasysh përkushtimin e studiuesit, Hamëz Lladrovci, në librin e tij me titull: “Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2022)”, me një prezantim të denjë të proceseve

dhe të ngjarjeve në një gjeohapësirë tepër të ndjeshme, siç është Ballkani dhe reflektimin gjeopolitik të diplomacisë rusomadhe, do të na motivojë më tepër për ta njohur gjeohapësirën së cilës i përkasim. Autori i këtij libri, Hamëz Lladrovci, i motivuar, pikërisht, nga rëndësia dhe nevoja e studimit të çështjes shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe, është munduar dhe ia ka arritur, që këtë punim shkencor ta botojë si libër, për t'i ofruar publikut shqiptar njohuri mbi fenomenin diplomatik dhe atij gjeopolitik të shtrirë në një rajon shumë të veçantë dhe me peshë të madhe gjeopolitike e gjeostrategjike, siç është Ballkani dhe rajoni rreth tij. Libri posedon strukturë dhe bërthamë të nisur me hipoteza dhe pyetje të qarta kërkimore, si objekt themelor studimi për autorin, por edhe një gamë të gjerë informacionesh, citimesh nga autorë botërorë, përfshirë këtu edhe analiza të thukta mbi diplomacinë dhe gjeopolitikën si fenomen, e mbi të gjitha dhe vetë aktin e ndikimit diplomatik të politikës rusomadhe, në rajonin e Ballkanit dhe gjeohapësirën shqiptare në atë rajon. Autori me të drejtë konstaton se mjeti diplomatik, si mjet gjeopolitik i politikës rusomadhe njëherit është edhe determinuese e fuqishme gjeopolitike, sepse edhe vetë gjeopolitika si

gjeopolitikë praktike në kuptimin e vet reflekton si: “raport, marrëdhënie midis vendeve”. Nga kjo, siç thekson autori, në rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në gjeohapësirën evropiane dhe ballkanike, zë fill koncepti ri «Koncerti i Evropës si koncept gjeopolitik», sipas të cilit: “problemet ndërkombëtare do t'i zgjidhnin bashkërisht Fuqitë e Mëdha Evropiane”, Sikurse e përfshin në librin e tij, në kontekstin gjeopolitik, karakteristike për këtë fazë është se në shtrirjen graduale të politikës, kemi shtrirjen: • E frymës “liberale demokratike”, por, edhe të: • Synimeve ekspansioniste të shteteve të mëdha të Evropës mbi ato të voglat. Në gjithë këtë vorbull dhe turbulencë gjeopolitike, jo pa ndikim, ka qenë vetë Rusia, roli i së cilës ka reflektuar në rrjedhat dhe në proceset, që ndërlidhën me Ballkanin e, në veçanti, me gjeohapësirën shqiptare. Kosova, Mali i Zi, ashtu dhe Maqedonia e Veriut në procesin e ndryshimit të diskursit politik e strategjik drejt NATO-s dhe BE-së janë ballafaquar jashtëzakonisht shumë me presionin e Rusisë dhe të politikës serbe dhe greke. Mjeti diplomatik, si mjet i fuqishëm gjeopolitik, ka zënë vend me rëndësi në librin e autorit, Hamëz Lladrovci. Me një sens prej studiuesi të vërtetë, i qaset studimit të politikave të jashtme të vendeve

ballkanike, duke ditur paraprakisht se determinuese e fuqishme e rrjedhave dhe proceseve politike e gjeopolitike të vendeve ballkanike ka qenë fuqia diplomatike e këtyre vendeve. Sot, siç konstaton autori, politika e jashtme përfaqëson qëndrimet, pozicionimin dhe objektivat e shteteve, përballë interesave ndërkombëtare. Shtetet e vogla, si ato ballkanike, paraqesin modelin tipik të peshës së tyre ndërkombëtare, përballë sfidave dhe tejkalimit të tyre gjatë proceseve të rëndësishme ndërkombëtare. Për këto vlime gjeopolitike ka dhe ka pasur shkrime të bollshme, por sikurse çdo herë autorët dhe studiuesit i kanë shtrembëruar, duke u shndërruar në vegël të interesave të pushteteve prej nga vijnë. Nga kjo edhe duhet parë motivimin e autorit të librit me titull: “Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2022)”, të studiuesit Hamëz Lladrovci, që njëherit është vazhdimësi e punimit të masterit me të njëjtin titull. Lidhur me praninë e fuqisë në Ballkan, sjell vlerësim të drejtë dhe të saktë për kohën. Sipas tij, duke u thirrur edhe në shumë studiues të nivelit botëror, si: Henry Kissinger, George Friedman etj. se «sot Ballkani, ashtu si në të kaluarën, përcakton peshën e influencës diplomatike të Fuqive të Mëdha botërore». Pozita shqiptare në këto

hapësira përcakton qartazi peshën e proceseve të ardhshme, jo vetëm të integritetit rajonal, por edhe të garantimit të paqes dhe të stabilitetit afatgjatë në tërë Evropën. Prezencën e diplomacisë amerikane në Ballkan, duhet kuptuar racionalist, si një veprim gjeostrategjik dhe gjeopolitik rajonal. SHBA-të janë prezent përherë të parë në Ballkan, dhe atë vetëm pas rënies së Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë. Në anën tjetër, BE vazhdon shtrirjen e ndikimit në Ballkanin Perëndimor, përmes reformave, konform legjislacionit të saj, anipse ky ndikim përballë diplomacisë amerikane mbetet ende larg. Qartësimi strategjik i diplomacisë evropiane mbi të ardhmen e Ballkanit mbetet e një rëndësie të madhe, veçanërisht, për neve si shqiptarë ballkanikë. Ballkani është gati të bëhet kufiri i ardhshëm gjeopolitik i shekullit XXI. Krejt në fund, më mbetet që të uroj dhe përgëzoj autorin e librit, z. Hamëz Lladrovci për punën e madhe e të shkëlqyer që ka bërë me këtë botim të librit me titull: “Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2022)”, për botimin e parë dhe për botimin e dytë! Autorit i uroj suksese të pafundme në karrierën e tij profesionale e shkencore të mëtejme!



Mr. sci. Hamz S. Lladrovci

Hamz (Smajl) Lladrovci u lind më 1969 në fshatin Gilanosellë të Drenasit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Drenas. Më pas u regjistrua në fakultetin e shkencave politike dhe administratë publike, ku merr thirrjen për studimet bachelor në shkencat politike dhe administratë publike. Pas mbarimit të fakultetit u regjistrua në studime master – drejtimi marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci. Këto studime i mbaroi me sukses shembullor, ku mori thirrjen shkencore të magjistrat (MAS). Hamz Lladrovci rrjedh nga një familje me traditë patriotike, e cila ka qenë e persekutuar dhe e ndjekur politikisht nga regjimi serbo-jugosllav. Kjo familje dha edhe dëshmorë të kombit. Hamz Lladrovci ka marrë pjesë në demonstrata të ndryshme, që u organizuan në Kosovë. Ndërsa, në demonstratë e janarit të vitit 1990 plagoset rëndë nga policia serbo-jugosllave, ku më pas transferohet për shërim jashtë vendit (Belgjikë). Ky transferim i shërbeu edhe për t'i ikur persekutimeve nga pushtuesi. Ai u vendos në Belgjikë. Pas një periudhe kohore shërohet. Pas këtyre aktiviteteve atdhetare, Hamza, mbetet në Belgjikë, ku pastaj martohet dhe krijoi familjen e tij. Në Belgjikë punoi dhe jetoi për një dekadë. Pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, si dhe pas dëbimit të okupatorit serb, Hamza kthehet për të jetuar dhe vepruar në vendlindje – në Drenas. Hamz Lladrovci është shqiptar, ndërsa, ka shtetësinë belge. Jeton në Drenas me familjen e tij.

Botuesi



ISBN 978-9951-28-147-8



9 789951 281478

Cmimi 20€

ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE 1856-2022

Mr. sci. Hamz S. Lladrovci

Botimi II-të

Mr. sci. Hamz S. Lladrovci



ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE 1856-2022



Prishtinë 2023

'Vdekja' e një Kryeministri

Mëngjesin e së martës 7 prill 2020, u ngarkova nga Daily Mail të shkruaja nekrologjinë e Boris Johnsonit. Në orën 7 pasdite, të hënën në mbrëmje, kryeministri ishte shtruar në njësinë e kujdesit intensiv në Spitalin St Thomas dhe askush nuk e dinte nëse do t'ia hidhte. Vdekja vuri dorën e saj të akullt mbi të, dhe sondazhet tregojnë se ai fitoi miratim dhe simpati më të madhe nga publiku, se sa në çdo kohë tjetër, para dhe pas kësaj. Për disa ditë, Johnsoni nuk ishte më Brexiteeri i urryer, populist i paskrupullt dhe gënjeshtar i pacipë, por një qenie njerëzore, e barabartë me çdo viktimë tjetër të pandemisë, e vdekshme si ne të tjerët.

Johnson është një njeri jashtëzakonisht, i vështirë për të shkruar për të. Kur i pyeta fëmijët e mi, atëherë njëzet e pesë, njëzet e një dhe nëntëmbëdhjetë vjeç, nëse mund t'ua kushtoja këtë libër, me kusht që të vendosja në një rresht se kishin rezerva të vogla për Johnsonin, njëri prej tyre u përgjigj: "Vetëm nëse themi se mendojmë që ai është një qenie njerëzore e poshtë dhe e neveritshme."

Boris Johnsoni frymëzonte të shumë njerëz një neveri të thellë; tek shumë të tjerë dashurinë dhe mbështetjen më të ngrohtë. Unë nuk aspiroj të ndryshoj mendimin e askujt për të: do të ishte një përpjekje e kotë.

Sapo filloj të shpjegoj pse Johnsoni nuk ka qenë, në periudha të caktuara të karrierës së tij, një dështim total, ekspozohem ndaj akuzës se po injoroj ose zbus gabimet e tij. Por çdo simpati që i shpreh atij (dhe nuk mendoj se Johnsoni mund të kuptohet pa një shkallë simpatie) mund të hidhet poshtë nga admiruesit e tij si keqardhje e pamjaftueshme.

Nuk kishte kohë për t'u shqetësuar për të gjitha këto ndërsa shkruaja nekrologjinë e tij për Daily Mail, e cila në një kohë tronditeje dhe zie kombëtare priste, supozova, një rrëfim që të paktën përfundonte me tone relativisht të favorshme. Kjo, përafërsisht, është ajo që u dërgova: "Boris Johnsoni e pëlqente këngën e "Chumbawamba", "Më rrëzojnë, por ngrihem përsëri. Nuk do të më mbani kurrë të gunjëzuar". Ai u rrezua shpesh, por deri kur jeta e tij u ndërpre nga Covid-19, gjithmonë ngrihej përsëri. Johnsoni ishte shumë më pak i kujdesshëm se politikan i zakonshëm i karrierës, ndërmori reziqe të cilat të tjerë i konsideronin si të çmendura, por u ringrit sërish, pas goditjeve që do të kishin shkërmoqur një figurë më pak elastike.

Me hyrjen në Commons në 2001 si deputet i Henley-t, ai vendosi, në kundërshtim me të gjitha këshillat e matura, që të mbetej redaktor i The Spectator. Politikanët e lartë dhe ekspertët e paralajmëruan se kalërimi i dy kuajve do të përfundonte në lot. I sfidoi parashikimet e tyre dhe në fillim gjithçka shkoi mirë. U bë gjithnjë e më i famshëm dhe në fillim të shtatorit 2004, Vanity Fair e quajti "deputeti konservator që një ditë mund të bëhej kryeministër". Michael Woolf, i cili shkroi profilin



për atë revistë, e krahasoi Johnsonin me dy aktorë të famshëm që kishin hyrë në politikë: Ai është, kur josh, magjeps dhe rrezaton humor të mirë, Ronald Reagan. Dhe Arnold Schwarzenegger... Ai është, mendoj unë, frymëzues." Asnjë deputet tjetër konservator nuk mund të krahasohej me Reaganin, një nga presidentët më të suksesshëm (megjithëse në fillim e tallën) amerikanë të pasluftës, ose me Schwarzenegger-in, i cili më pas shërbeu si guvernator i Kalifornisë. Johnsoni kishte një aftësi mahnitëse për t'ulidhur me publikun e gjerë. Ai kishte cilësi të yjeve dhe konservatorët filluan të mendonin, se ai mund të ishte lideri që do t'i jepte fund dekadës së suksesit të laburistëve nën Tony Blairin.

Në verën e vitit 2004 fillova punën për vëllimin e parë për Johnsonin, botuar në 2006 dhe përditësuar në 2007, 2008, 2012 dhe 2016. Ai në fillim ishte jashtëzakonisht i entuziasmuar nga ideja e një libri ku flitej për gjithçka rreth tij ("Kaq kolosal është vaniteti im, sa që nuk kam ndërmend të përipiqem të të ndaloj"), por më pas u ftoh ("Çdo gjë që supozohet të thotë të vërtetën do të ishte vërtet e patolerueshme"), dhe më ofroi 100,000 sterlina për ta braktisur projektin, që unë, i mërziur nga ideja që ai mendonte se mund të më blinte, i refuzova.

Në tetor 2004, The Spectator botoi një editorial në të cilin abuzonte me njerëzit e Liverpool-it dhe bëri disa gabime mizore në lidhje me fatkeqësinë e Hillsborough. Pati bujë dhe Michael Howard, lideri i Partisë Konservatore, i cili ishte një tifoz i Liverpool-it, u paralajmërua se herën tjetër që do të shkonte në një ndeshje do të fërshëllehej. Howard u zemërua dhe urdhëroi Johnsonin të shkonte dhe t'u kërkonte falje tifozëve të Liverpool-it, duke folur vetëm për mediat lokale. Këtë e bëri Johnsoni, por shtypi kombëtar ishte i vendosur të mbulonte edhe ai lajmin, dhe gjatë vizitës së tij në qytet u shkaktua një rrëmujë mediatike që argëtoi mbarë vendin, por e bëri Howardin të dukej qesharak.

Më keqja do të vinte. Johnsoni hodhi poshtë artikujt e shtypit për lidhjen e tij me Petronella Wyatt si "një piramidë e përmbytur broçkullash", shtypi vërtetoi se ai po

gënjente dhe Howard, i cili e kishte promovuar vetëm disa muaj më parë në postin e zëdhënësit në hije për Artet, e shkarkoi. Nga fundi i vitit 2004, karriera politike e Johnsonit ishte në gërmadha. Shumë nga kolegët e tij deputetë konservatorë, xhelozë për famën dhe të zemëruar nga neglizhenca e detyrave parlamentare, kishin arritur në përfundimin se ai ishte i pandershëm dhe jo i besueshëm. Kështu që, kur Howard humbi zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2005 dhe dha dorëheqjen nga udhëheqja e konservatorëve, Johnsoni nuk ishte në pozicion të mirë për të bërë një ofertë për postin vakant, dhe në vend të kësaj mbështeti David Cameronin, i cili fitoi. Cameron kishte qenë më i vogël se ai në Eton, më i vogël se ai në Oksford, kishte një mendje më pak origjinale dhe, derisa u bë lider, ishte më pak i famshëm se Johnsoni, i cili kishte patur qasje në publikun e gjerë duke dhënë një seri performancash zbavitëse në "Kam lajme për ty".

Dhjetë vitet e ardhshme i përkisnin Cameronit të matur dhe profesionist, jo Johnsonit të papjekur dhe joserioz, i cili duhej të kënaqej me postin e vogël të zëdhënësit në hije për arsimin e lartë. Në vitin 2006, në festën e lançimit të një libri që kishte shkruar për Romën e lashtë, Johnsoni tha në fillimin e tij: "Nganjëherë pyes veten se çfarë bëjnë njerëzit si unë në jetën publike" dhe vazhdoi: "Besoj është që ne shpresojmë të bëhemi zëdhënës në hije për arsimin e lartë."

Ishte për të qeshur sepse ishte qartësisht një marrëzi. Johnsoni dëshironte të bëhej kryeministër, por e dinte se nuk do të arrinte asgjë në Westminster për sa kohë që Cameroni ishte në krye. Mary Wakefield, e cila punonte tek "The Spectator", ishte ndër personat që sugjeruan që Johnsoni të përballej me Ken Livingstone, kryebashkiak i Londrës, në zgjedhjet që do të mbaheshin në maj 2008. Problemi ishte se Livingstone konsiderohej i pathyeshëm. Avantazhi ishte se Johnsoni do të hynte në një garë popullariteti, në të cilën aftësia e tij për të rrokur publikun e gjerë, duke përfshirë ata që urrenin politikanët konvencionalë, mund të ishte një as

nën mëngë.

Johnsoni guxoi të dilte kundër Livingstonit të pushtetshëm, diçka që asnjë konservator tjetër i shquar nuk ishte i përgatitur të bënte, dhe fitoi, me çrast dha dorëheqjen nga vendi i tij në parlament. Ai ishte treguar një aktivist dhe shpejt filloi të shkëlqente si ambasador i Londrës, që do të ngrihej në mbrojtje të metropolit kundër qeverisë qendrore. Ai punësoi individë të talentuar si Simon Milton për punët administrative, për të cilat temperamentit që kishte e bënte atë vetë të papërshtatshëm. Në maj të vitit 2012, Johnsoni mundi përsëri Livingstone dhe atë verë ai mirëpriti botën në Londër, me rastin e Olimpiadës.

Mediat dhe shumë londinezë prisnin që Lojërat të ishin një telash, me trenat dhe autobusët që nuk mund të përballonin kaq shumë vizitorë. Johnsoni këmbënguli që Lojërat do të ishin një triumf dhe u vërtetua që ai kishte të drejtë. Ai vazhdoi të dominonte çdo dalje publike të përbashkët me Cameronin, i cili prej vitit 2010 kishte shërbyer si kryeministër.

Gjatë Lojërave Johnsoni ngeci i varur në litër, një situatë e sikletshme që e popullarizoi edhe më shumë. Në një rast tjetër të famshëm, i rrëmbyer nga shpirti i garës që e karakterizon, ai goditi me regbi një lojtar gjerman, ndërsa merre pjesë në një ndeshje bamirësie – gjë që shumica e njerëzve as nuk do ta mendonin ta bënin. Në një rast tjetër, hodhi përdhe një fëmijë japonez ndërsa luante regbi. Sjellja e Johnsonit ishte një fyerje për idenë e njerëzve me mendje serioze, se si duhet të drejtohet politika.

Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2015, Johnsoni u kthye në Westminster, tashmë si deputet në Uxbridge, në përfundim të Londrës, në mënyrë që të pretendonte se po përfaqësoje qytetin për të cilin do të mbetej kryetar bashkie deri vitin e ardhshëm. Në fillim nuk ishte e qartë se për çfarë do të duheshin në Westminster dhuntitë e Johnson-it si fushatëbërës. Cameroni, për habitje e gjerë, kishte arritur të fitonte një shumicë të ngushtë për konservatorët në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2015, pa ndonjë ndihmë të veçantë nga

Johnsoni. Por Cameroni me zor kishte qenë në gjendje të mbante të bashkuar partinë konservatore dhe të zbehte kërcënimin e UKIP, duke premtuar që, nëse fitonte zgjedhjet, do të mbante një referendum mbi anëtarësinë e Britanisë së Madhe në BE.


Ky ishte shansi i Johnsonit. Me mjeshtërinë e tij të teatralitetit politik, ai u lëkund midis atyre që donin qëndrimin dhe të tjerëve që donin largimin, pranoi se 'po vërtitej gjithandej si një karrocë supermarketi', madje bëri të ditur se kishte shkruar dy artikuj të kundërt për Daily Telegraph, njëri në favor të qëndrimit në BE dhe njëri pro largimit. Në kohën e çajit, pasditen e së dielës 21 shkurt 2016, ai doli nga shtëpia e tij e bukur në Islington dhe shpalli para turmës së emocionuar të gazetarëve që ishin mbledhur jashtë, se do t'i bashkohej fushatës për largimin. Johnsoni u përball me Cameronin, duke u bërë zëri i votuesve euroskeptikë të Britanisë, të cilët e ndjenin veten të përbuzur dhe të injoruar nga establishmenti pro-evropian. Ai shpërfaqti sërish aftësitë si një mjeshtër fushatash, që ndryshe nga pothuajse çdo politikan tjetër britanik, mund të hynte në një qendër tregtare të zymtë të mërkurës pasdite dhe ta gjallëronte në çast".

Dhe kështu nekrologjia vazhdonte e vazhdonte. Daily Mail po më kërkonte kopjen time, e vendosur që artikullin ta kishte gati për botim në momentin që kryeministri ndërronte jetë. Tashmë kisha arritur ta çoja Johnsonin në Downing Street. Pak çaste më vonë në artikull, e dërgova në atë botë.

"Pastaj erdhi pandemia. Kërkonte një ndryshim në ton: Johnsoni duhej të frenonte egërsinë e tij natyrore. Këtë e bëri dhe tregoi se po punonte natë e ditë me ekipin e tij për ta mbrojtur kombin nga rreziku, pavarësisht çdo rreziku që shfaqej për shëndetin e tij. Karriera e tij është shkurtuar mizorisht në një pikë kur ai sapo kishte arritur sukseset e veta më të mëdha – Brexit dhe fitoren e zgjedhjeve të dhjetorit 2019 – dhe dukej i vendosur që për shumë vite të rrinte në krye të vendit, për të zhvilluar vizionin e tij për konservatorizmin. Shumë njerëz që nuk e patën besuar kurrë, e kuptuan në fund se ky njeri që prej kohësh u dukej thjesht një shakaxhi, ishte në të vërtetë një burrë shteti me dhunti të jashtëzakonshme politike, komunikuesi më i shkëlqyer i brezit të tij, i shtyrë jo vetëm nga një etje e zjarrtë për famë, por edhe nga një dashuri e thellë për vendin e tij dhe një vendosmëri për t'i shërbyer me sa fuqi që kishte".

Johnsoni nuk vdiq dhe armiq të tij, disa prej të cilëve u befasiuan kur zbuluan se, në çastet kur ai ishte në prag të vdekjes, kishin ndjenja të buta për të, shpejt u kthyen tek krahasimi me Hitlerin, apo Mbretin John, i konsideruar si monarku më i keq në historinë angleze.

Shkëputur nga Libri "Boris Johnson, ngjitja dhe rënia e një ngatërrestari" me autor Andrew Gimson (bota.al)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Hidhet shorti për "Elite Round" për kualifikimet e Euro 2024, Kosova në grupin e parë

NION, 7 DHJETOR - Në selinë e UEFA-s në Nion të Zvicrës është tërhequr shorti për "Elite Round" në kualifikimet e Kampionatit Evropian 2023/2024 për kombëtaren U19. Në këtë fazë janë gjithsej 7

grupe me nga 4 skuadra, derisa Kosova bën pjesë në grupin e parë së bashku me Spanjën, Austrinë dhe Slloveninë. Turneu kualifikues i këtij grupi do të mbahet në Slloveni, ndërsa datat kur do të

zhvillohen ndeshjet janë 20/23/26 mars 2024. Kualifikimin për në Evropian e sigurojnë skuadrat lidere të grupeve përkatëse. Dardanët U19 arritën të kualifikohen në "Elite Round"

pasi tubuan pesë pikë në Grupin 7 të fazës së parë kualifikuese që u zhvillua muajin e kaluar e ku ishin të përfshira edhe Ukraina, Sllovakia dhe Malta.



FBK-ja dhe FShB-ja pajtohen për Ligën Unike

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Krerët e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) kanë pritur sekretarin e përgjithshëm të Federatës Shqiptare të Basketbollit (FShB), Franko Bushati, i cili sapo është emëruar në këtë pozitë, ndërsa ishte i shoqëruar nga Ersi Oruci, përgjegjës për Ligën Unike në FShB.

Bushati dhe Oruci janë pritur në FBK nga numri një i FBK-së, Arben Fetahu, sekretarja e përgjithshme Elvira Dushku dhe menaxheri i përfaqësuesve, Adriatik Rraci.

Bushati ka një karrierë të pasur sportive. Ka qenë basketbollist i Kombëtares shqiptare për shumë vjet dhe ka luajtur në elitën e

basketbollit të Italisë, si dhe në shumë skuadra italiane.

Fetahu e ka uruar Bushatin për pozitën e re në FShB, duke i uruar suksese si dhe bashkëpunim maksimal për zhvillimin e basketbollit në Shqipëri.

Krerët e FBK-së dhe Bushati kanë folur për projektet e përbashkëta, me theks të veçantë vazhdimin e projektit të Ligës Unike.

Të dyja palët janë pajtuar për fillimin e Ligës Unike për Femrat, ku do të garojnë tri skuadrat më të mira nga Kosova dhe tri më të mirat nga Shqipëria në bazë të renditjes të edicionit të kaluar.

Liga pritet të fillojë në muajin janar të vitit të ardhshëm dhe të përfundojë në fund të marsit me

organizimin e Final Four në Kosovë.

Ndërsa Liga Unike për meshkuj do të zhvillohet në formë të turneut të Final 8, me katër skuadrat më të mira nga Kosova e Shqipëria të edicionit të kaluar.

Final 8 do të zhvillohet në fund të muajit mars në Shqipëri.

Kalendari për Ligën Unike për femra dhe meshkuj do të publikohet shumë shpejt.

Në fund i Bushati ka falënderuar Fetahun dhe Dushkun për mikpritjen dhe i ka përgëzuar për të arriturat e deritanishme, duke u uruar suksese në vitin 2024, ku FBK ka fituar të drejtën për të organizuar pesë gara ndërkombëtare.



Trajneri i Sllovenisë: Shqipëria nuk mund të nënvlerësohet

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Ndonëse është në grupin më të vështirë të mundshëm në Kampionatin Evropian të Futbollit, Shqipëria nuk mund të nënvlerësohet. Kështu ka thënë trajneri i Sllovenisë, Matjaz Kek, i cili ka udhëhequr përfaqësuesen e tij drejt Evropianit që mbahet verën e ardhshme në Gjermani.

Në intervistat dhënë për mediet kroate lidhur me shortin e së shtunës së kaluar dhe për Evropianin, trajneri slloven ka folur vazhdimisht me shumë respekt për kuqezinjtë të cilët ndodhen në Grupin B të "Euro 2024"-s me Spanjën, Kroacinë dhe Italinë. "Nëse duhet të brengoset dikush në këtë grup, atëherë është dikush tjetër dhe jo Kroacia, që është e dyta dhe e treta në botë dhe finaliste e Ligës së Kombeve. Qartë se nuk është grupi më i lehtë për Kroacinë. Një gjë dua ta theksoj, se Shqipëria assesi nuk



mund të nënvlerësohet", ka theksuar Kek për faqen kroate "net.hr".

Trajneri slloven ka theksuar se Kroacia do ta ketë më vështirë ndaj Shqipërisë se ndaj Spanjës dhe Italisë. "Jam i bindur që kroatët më vështirë do ta kenë me Shqipërinë,

që e ka fituar grupin, se ndaj Spanjës apo Italisë", ka pohuar tekniku slloven.

Shqipëria dhe Sllovenia marrin pjesë për herë të dytë në fazën finale të një Evropiani. Kuqezinjtë rikthehen pas 8 vjetësh, ndërsa skuadra e Kekut pas plot 24 vjetësh.

Prishtina 01, Drenica, Liqeni dhe Mabetex Prishtina, skuadrat gjysmëfinaliste të Kupës në futsall



PRISHTINË, 7 DHJETOR - Janë zhvilluar ndeshjet çerekfinale të Kupës së Kosovës në futsall. Edhe ky rreth solli rezultate të pritura. Tutje kaluan skuadrat favorite të cilat realizuan fitore bindëse.

Prishtina 01, Drenica, Liqeni dhe Mabetex Prishtina do të luajnë në gjysmëfinale, ndeshje të cilat janë paraparë të zhvillohen me sistem vajtje-ardhje me datat 24 shkurt dhe 2 mars të vitit të ardhshëm.

REZULTATET:

Prishtina 01 - Vjosa 5:1
Drenasi - Drenica 1:4
Fidacom - Liqeni 2:4
Prishtina - Mabetex Pr 2:5

Më 9 dhjetor mbahet Kuvendi i Shoqatës së Trajnerëve

Prishtinë, 7 dhjetor - Shoqata e Trajnerëve e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se më 9 dhjetor do ta mbajë

Kuvendin e Punës, njëherësh zgjedhor. Punimet e këtij kuvendi do të mbahen në selinë e FFK-së në

orën 11:00. Bordi i Shoqatës fton delegatët e këtij kuvendi nga të gjitha shoqatat e lidhjeve rajonale që

të jenë të pranishëm, teksa materiali i kuvendit do t'u dërgohet paraprakisht në e-mail.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

K O N K U R S

**Për zgjedhjen e një (1) anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës,
përfaqësues nga shoqëria civile**

Në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor për zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, Kuvendi shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

Një (1) anëtar/e, përfaqësues nga shoqëria civile.

I. Kandidati për anëtar në Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
3. Të ketë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
4. Të ketë përvojë pune në çështjet ligjore së paku pesë (5) vjet;
5. Të ketë përkrahjen e së paku pesë (5) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
6. Të mos jetë i dënuar për vepër penale.

II. Shoqëria civile duhet t'i bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati i plotëson kushtet e paraqitura në këtë shpallje publike.

III. Kuvendi i Kosovës inkurajon shoqërinë civile, që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të KPK-së, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar të barazisë gjinore.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 27.12.2023, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
Forma elektronike: faja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

K O N K U R S

**Za izbor jednog (1) člana Tužilačkog Saveta Kosova, predstavnika
civilnog društva**

Shodno članovima 9. i 10. Zakona 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova i u cilju ispunjenja zakonske obaveze da se izabere član Tužilačkog saveta Kosova, Skupština objavljuje konkurs za popunu radnog mesta:

Jedan (1) član/ica, predstavnik/ica civilnog društva.

I. Kandidat za člana Tužilačkog saveta Kosova, treba da ispuni sledeće uslove:

1. Da bude državljanin i stanovnik Republike Kosovo;
2. Da ima visoku stručnu spremu u oblasti pravde;
3. Da poseduje znanje iz oblasti ljudskih prava;
4. Da ima radno iskustvo u pravnim pitanjima najmanje pet (5) godina;
5. Da imaju podršku najmanje pet (5) organizacija civilnog društva na polju pravde;
6. Da nije osuđen za krivično delo.

II. Civilno društvo u spisku kandidata nominovanih za člana mora priložiti i dokumente koji dokazuju da kandidat ispunjava uslove predstavljene u ovom javnom oglasu.

III. Skupština Kosova podstiče civilno društvo, kada podnosi predloge za člana TSK-a, da uzme u obzir multietnički sastav Republike Kosovo i prihvaćene principe rodne ravnopravnosti.

Aplikaciji se treba priložiti i sledeći prateći dokumenti:

- Biografija (Curriculum vitae);
- Potvrda o školskoj i profesionalnoj pripremi (diplome univerziteta u inostranstvu mora nostrifikovati Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđen za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 27.12.2023. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, N-217).

Aplikaciju možete uzeti u:

Štampanoj formi: na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u
Elektronskoj formi: internet-stranica Skupštine Republike Kosovo - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 07.12.2023 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-23-13

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e parcelës, të Industrisë Kimike, pranë magjiistralessë Adriatikut (afër tunelit)

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë

Data e shpalljes: 07.12.2023

Sqarimi: deri me 15.12.2023

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 15.12.2023
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e shitjes.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)

Afati i fundit i dorëzimit: 15.12.2023 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes në Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku inustrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Behxhet NIMANI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>behxhetnmani@hotmail.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepçasha.com</i>		

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës te pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madhe apo i barabarte me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Kosovo Cumhuriyeti

Datë 07.12.2023

Nr. 2355/23

Në bazë të nenit 10 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Edukimit në Fëmijërinë e Hershme Nr. 08/L-153, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, nenit 8 të Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik; në kuadër të marrëveshjes në mes të Save the Children, DKA, DKSH dhe DKPMS nr. 2280/23, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, shpall:



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

1. Titulli i vendit të punës: Edukatore për edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 3-5 vjeçare)
Numri i Pozitave: 1
Në shkollën:
ShFMU "Mati Logoreci" në Prizren

Kualifikimi i kërkuar:

- Fakulteti i edukimit – programi katërvjeçar i nivelit baçelor për edukimin parashkollor
- Shkolla e lartë pedagogjike – drejtimi për edukatorë
- Fakulteti filozofik - dega e pedagogjisë së përgjithshme
- Të gjithë kandidatët e kualifikuar në programin "Përkujdesje-mirëqenie e fëmijëve" të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ 05/2021.

Rekutimi i Edukatores për edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 3-5 vjeçare) bëhet në bazë të marrëveshjes në mes të Save the Children, DKA, DKSH dhe DKPMS nr. 2280/23, në kuadër të projektit "Përmisimi i qasjes dhe cilësisë në kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme në Kosovë" (nr. 17982).

Kohëzgjatja e kontratës së punës: me kohë të caktuar deri me 30.06.2025.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatit planet e lëndës në bazë vjetore, mujore, javore dhe ditore të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Mban orën mësimore sipas orarit të paracaktuar
- Planifikon, vëzhgon, mbikëqyr dhe udhëheq nxënien dhe sjelljen e secilit nxënës,
- Zbaton metodologji të reja të mësimdhënies dhe vlerësimit,
- Kujdeset dhe ndjek zhvillimin profesional-trajnimet,
- Koordinon punën sipas kërkesave të administratës së shkollës;
- Organizon aktivitete jashtëshkollore;
- Merr pjesë në të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e shkollës;
- Përgatit raportet e nevojshme, për nevojat e administratës së shkollës;
- Komunikon dhe bashkëpunon me prindërit dhe nxënësit e shkollës, kolegët dhe adiminsitratën;
- Bashkëpunon dhe merr pjesë në punën e organeve të shkollës, në organizimet e shkollës, dhe aktivitetet ekstrakurrikulare;
- Kryen edhe punë të tjera të lidhura me aktivitetin mësimor të caktuara nga drejtori bazuar në legjisllacionin në fuqi.

Dokumentacioni i kërkuar:

- (në kopje fizike)
- Fotokopja e Letërnjoftimit
- Diploma e Fakultetit (kopja e noterizuar)
- Nostifikimi, nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Kosovës
- Ekstrakti i lindjes

Dokumentet që do të kërkohen për kandidatët të cilët përzgjidhen

- Vërtetimi/dëshmia se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepër të padenjë që përfshinë fëmijët.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (kandidati/ja e sjell pas përzgjedhjes sipas procedurës.
- Të gjitha dokumentet origjinale kandidati/ja i/e përzgjedhur i sjell për verifikim sipas procedurave.

-Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë kalendrike nga data **08.12.2023 deri më 22.12.2023** që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit.

-Aplikimet e dorëzuara pas afatit të parashikuar nuk pranohen dhe aplikimet me mangësi refuzohen.

-Aplikacioni për konkurim merret në faqen e Komunes së Prizrenit. Pas plotësimit sipas çdo pike të aplikimit, bashkëngjiten dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren.

VËMENDJE: Aplikimet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar brenda afatit për dorëzimin e aplikimeve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashikohet nga legjisllacionin në fuqi. Konkursi dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunes së Prizrenit.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/konkurset/>

Drejtoria e Arsimit në Prizren
Drejtoresha/Luljeta Vesela Gutaj

